



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.189

dhjetor

2009

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.1173, datë 6.11.2009	Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura	8333
Udhëzim i MF nr.52, datë 28.12.2009	Për përcaktimin e procedurave dhe afateve për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor	8334
Vendim i GJK nr.32, datë 28.12.2009	Me objekt shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.781, datë 12.6.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.....	8335
Vendim i ERE nr.93, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8340
Vendim i ERE nr.94, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlorë sh.a. te furnizuesi publik me shumicë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8341
Vendim i ERE nr.95, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8341
Vendim i ERE nr.96, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8342
Vendim i ERE nr.97, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8342
Vendim i ERE nr.98, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8343

Vendim i ERE nr.100, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8344
Vendim i ERE nr.101, datë 15.12.2009	Për përcaktimin e çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010	8346
Vendim i ERE nr.102, datë 21.12.2009	Për licencimin e shoqërisë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike	8346
Vendim i ERE nr.103, datë 21.12.2009	Për miratimin e marrëveshjes së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet termocentralit Vlorë sh.a. (Tec Vlora sh.a.) dhe shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë)	8347
Vendim i ERE nr.104, datë 22.12.2009	Për përcaktimin e kohëzgjatjes për faturimin aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike	8349
Vendim i ERE nr.105, datë 28.12.2009	Mbi ankimin e OSSH sh.a. për vendimet e Bordit të Komisionerëve nr.98, datë 15.12.2009 dhe nr.100, datë 15.12.2009	8349
Vendim i ERE nr.106, datë 29.12.2009	Për licencimin e shoqërisë “Energji Ashta” sh.p.k.....	8350
Vendim i ERE nr.107, datë 29.12.2009	Për fillimin e procedurave për licencimin e shoqërisë “HEC Bishnica 1, 2” sh.p.k.....	8351
Vendim i ERE nr.108, datë 29.12.2009	Për një ndryshim në vendimin nr.29, datë 16.4.2009 “Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2009 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike”	8352
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Veri Dika dhe caktimin e bashkëshortes, Trendeline Dika si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.....	8352

VENDIM
Nr.1173, datë 6.11.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE PËR ORGANIZIMIN E NGJARJEVE
KULTURORE, ARTISTIKE DHE SOCIALE NGA ORGANET E QEVERISJES QENDRORE
DHE INSTITUCIONET E TJERA PUBLIKE, TË PAVARURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.9631, datë 30.10.2006 “Për artin skenik”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rregulla të përgjithshme:

1. Ky vendim ka për qëllim përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore dhe artistike e të veprimtarive të lidhura me to nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura.

II. Procedurat e organizimit:

2. Titullari i institucionit urdhëron, me shkrim, blerjen e shërbimit e të mallrave, për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore, sociale dhe artistike nga operatorët e fushës, duke parashikuar, për çdo rast, objektin, nevojën e kryerjes së programit, fondin limit dhe përbërjen e komisionit, për ndjekjen e procedurave.

3. Përzgjedhja e operatorëve të specializuar, në varësi të llojit të ngjarjes, të bëhet sipas kushteve të mëposhtme:

a) Përvojës në organizimin e ngjarjeve;

b) Çmimit të ofruar nga operatorët e specializuar.

4. Komisioni për ndjekjen e procedurave dhe hartimin e dokumenteve përbëhet nga 5 anëtarë, 3 prej të cilëve janë specialistë të fushës.

5. Komisioni, brenda një periudhe kohore 5-ditore nga data e daljes së vendimit, u shpërndan, me korrespondencë zyrtare, operatorëve/agjencive të specializuara ftesën për negociata, e cila duhet t’u dërgohet të paktën dy operatorëve.

6. Në ftesën për negociata duhet të përcaktohen objekti i programit, ngjarjes, nevoja e kryerjes së programit/ngjarjes, fondi limit dhe data përfundimtare për paraqitjen e ofertës nga operatorët dhe agjencitë.

7. Komisioni pret, brenda afatit të fundit të paraqitur në ftesën për negociata, konfirmimin nga operatorët/agjencitë e specializuara për vazhdimësinë e negociatave, i cili shoqërohet me çmimin përkatës për kryerjen e programit/ngjarjes, nga operatorët/agjencitë e specializuara. Konfirmimet për vazhdimësinë e negociatave vijnë në një ditë të vetme, të mbyllura dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit.

8. Komisioni, pas analizimit të ofertave të paraqitura, përzgjedh, në bazë të pikëve, operatorët/agjencitë e specializuara, duke u bazuar në kushtet e veçanta, të përcaktuara në pikën 3, të këtij vendimi, si dhe harton një raport të hollësishëm për të gjithë procedurën e ndjekur, raport të cilin ia paraqet titullarit të institucionit.

9. Titullari i institucionit, në bazë të rekomandimit të dhënë nga komisioni i vlerësimit, vendos, brenda 2 ditëve nga data e paraqitjes së rekomandimit, lidhjen e kontratave me operatorin/agjencinë e specializuar, për organizimin e ngjarjes.

III. Dispozita të fundit

10. Ankesat për procedurën e blerjes, të shërbimit dhe mallrave, për zhvillimin, prodhimin apo bashkëprodhimin e programeve kulturore, sociale dhe artistike nga operatorët e fushës bëhen te drejtuesi i institucionit. Vendimi i tij është përfundimtar.

11. Vendimi nr.309, datë 21.6.1993 i Këshillit të Ministrave “Për shpërblimin e cilësisë artistike në letërsi, artin figurativ, muzikor, kinematografik, ekzekutiv, interpretativ, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore”, shfuqizohet.

12. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

UDHËZIM
Nr.52, datë 28.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE DHE AFATEVE PËR SHTYPJEN DHE SHPËRNDARJEN E DOKUMENTACIONIT TATIMOR

Në mbështetje të nenit 102 pika 4 të Kushtetutës, të nenit 135 pika 2 të ligjit nr.9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë“, të ndryshuar, si dhe pikës 7 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor” Ministri i Financave

UDHËZON:

1. “Shtypshkronja e letrave me vlerë“, sh.a. me kapital tërësisht shtetëror në varësi të Ministrisë së Financave do të mundësojë shtypjen e dokumentacionit tatimor sipas porosisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe kushteve të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.1149, datë 25.11.2009 “Për shtypjen dhe shpërndarjen e dokumentacionit tatimor”.

2.Shtypshkronja pranon porosi vetëm nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar vetëm te porositësi.

Shtypshkronja e letrave me vlerë” sh.a.nuk pranon asnjë porosi që nuk vjen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Të drejtën e shpërndarjes së dokumentacionit tatimor e ka vetëm administrata tatimore qendrore.

3.Procedura për fillimin e shtypjes së dokumentacionit tatimor fillon me nënshkrimin e kontratës midis Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe “Shtypshkronjës së letrave me vlerë” sh.a., e cila duhet të garantojë prodhimin e dokumentacionit sipas specifikimeve teknike, formateve, modeleve, kushteve. Sasia, cilësia dhe garancia e mallit të kërkuar do të përcaktohen në kontratën e lidhur midis dy palëve.

4.Formati, informacioni apo standardet e sigurisë të çdo dokumenti tatimor që do të prodhohet do të jenë të miratuara nga Ministri i Financave apo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Në momentin që Ministria e Financave apo Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve vendosin të ndryshojnë një nga dokumentet tatimore, të miratojnë një dokument të ri ose të heqin nga qarkullimi një dokument tatimor, brenda 5 ditëve pas marrjes së vendimit duhet të njoftohet edhe shtypshkronja e letrave me vlerë sh.a.

5. “Shtypshkronja e letrave me vlerë“ sh.a. para lidhjes së kontratës, përgatit analizën e kostos për çdo dokument tatimor që do të prodhohet.

Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve ngre një komision të posaçëm, i cili shqyrton dhe vendos lidhur me koston e paraqitur nga shtypshkronja e letrave me vlerë sh.a., si dhe harton specifikimet teknike për çdo dokument tatimor.

6.Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

VENDIM
Nr.32, datë 28.12.2009

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Kujtim Puto	Anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i “ “
Petrit Pilloçi	Anëtar i “ “
Sokol Sadushi	Anëtar i “ “
Sokol Berberi	Anëtar i “ “
Vitore Tusha	Anëtare e “ “
Admir Thanza	Anëtar i “ “
Fehmi Abdiu	Anëtar i “ “

me sekretare Blerina Çinari, në datën 10.09.2009 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë dokumentesh çështjen nr.16 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Violeta Kanani, përfaqësuar nga av. Avni Shehu, me deklaram.

SUBJEKTI I INTERESUAR: Bashkia Fier, përfaqësuar nga Luan Çala, me autorizim.

OBJEKTI: Shfuqizimi si antikushtetues i vendimit nr.781, datë 12.6.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f, dhe 134/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Fehmi Abdiu; kërkuesin që u shpreh për pranimin e kërkesës; përfaqësuesin e subjektit të interesuar që u shpreh për rrëzimin e kërkesës dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Kërkuesja Violeta Kanani, ka qenë pronare e kampingut “Radi”, i cili ka shërbyer për strehimin e të ardhurve nga Kosova gjatë periudhës së luftës 22.4.1999 - 7.7.1999. Ajo ka pasur një marrëveshje me bashkinë Fier për strehimin dhe ushqimin e të ardhurve, marrëveshje që do realizohej nga subjekti i interesuar kundrejt një shpërblimi. Bashkia Fier ka përmbushur vetëm pjesërisht detyrimin e saj, edhe pas disa përpjekjesh për t’u mirëkuptuar.

Me vendimin nr.909, datë 29.5.2003, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier ka vendosur pranimin e kërkesëpadisë dhe ka detyruar palën e paditur të paguajë në favor të palës paditëse shumën e detyrimit prej 4.807.260 lekësh kamatëvonesat në shumën 3.732.160 lekë, si dhe kamatë vonesat deri në momentin e ekzekutimit të vendimit.

Me vendimin nr.514, datë 26.12.2003 Gjykata e Apelit Vlorë ka lënë në fuqi vendimin nr.909, datë 29.5.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Me vendimin nr.572, datë 14.4.2005 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur prishjen e vendimit nr.514, datë 26.12.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues.

Me vendimin nr.8, datë 7.3.2006 Gjykata e Apelit Vlorë ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr.909, datë 29.05.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Mbi rekursin e subjektit të interesuar, me vendimin nr.781, datë 12.6.2007 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur ndryshimin e vendimit nr.8, datë 7.3.2006 të Gjykatës së Apelit

Vlorë dhe të vendimit nr.909, datë 29.5.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, si dhe rrëzimin e padisë.

Kërkuesja ka kërkuar shfuqizimin e vendimit nr.781, datë 12.6.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë për këto arsye:

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vepruar në kundërshtim me kompetencat e tij që lidhen me ushtrimin e funksionit rishikues, të parashikuar në nenet 472/b dhe 485 të Kodit të Procedurës Civile (K Pr Civile). Ai ka rivlerësuar në mënyrë të ndryshme provat që janë administruar gjatë gjykimit në shkallën e parë dhe në gjykatën e apelit. Veç këtyre, Kolegji ka vlerësuar në mënyrë të ndryshme rrethana me rëndësi që kanë lidhje me thelbin e çështjes;

- Ky kolegji, në vendimin e tij, nuk jep përgjigje të arsyetuara dhe logjike të provave të pranuar nga dy gjykatat më të ulëta, si dhe të problemeve ligjore, duke shkelur edhe detyrimin për arsyetimin e vendimeve nga ana e gjykatave. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk ka arsyetuar se për cilat shkaqe kanë ndryshuar rrethanat e çështjes dhe për çfarë shkaqesh nuk ka pranuar interpretimet juridike që kanë bërë të dy gjykatat, e shkallës së parë dhe të dytë;

- Është shkelur parimi i paanësisë, sepse Gjykata e Lartë ka vendosur dy herë për të njëjtën çështje, duke mbajtur qëndrime të ndryshme.

Subjekti i interesuar ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, duke pretenduar se nuk ka ekzistuar një marrëdhënie detyrimi e aq më tepër një kontratë mes bashkisë Fier dhe kërkueses.

II

Lidhur me pretendimin e kërkueses se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka dalë jashtë funksionit rishikues sipas urdhërimeve të neneve 472 dhe 485 të K.Pr.Civile.

Kërkuesja pretendon se vendimi nr.781, datë 12.6.2007 i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është antikushtetues, pasi shkel të drejtën kushtetuese për garantimin dhe mbrojtjen e pronës private sipas nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut. Sipas kërkueses, vendimi i mësipërm nuk ka respektuar kërkesat e nenit 472 të K.Pr.Civile, pasi Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka kapërcyer kompetencat duke dalë tej juridiksionit rishikues, gjë që ka çuar në përfundime të ndryshme nga ato të gjykatave të tjera edhe përsa i përket rrethanave të faktit të pranuar prej tyre.

Për t'u shprehur në lidhje me këtë pretendim, Gjykata Kushtetuese (Gjykata) e çmon të nevojshme të ripërsërisë vlerësimet e jurisprudencës së saj në lidhje me funksionin rishikues të Gjykatës së Lartë, parashikuar në nenin 141 të Kushtetutës, sipas të cilit, ajo duhet të aplikojë të drejtën mbi faktet, duke e interpretuar dhe zbatuar drejtë dhe në mënyrë të njëzuar në të gjithë sistemin gjyqësor. Në këtë koncept është mbështetur neni 141 i Kushtetutës duke përcaktuar Gjykatën e Lartë si gjykatë që kompetencën e saj në lidhje me funksionin rishikues ta aplikojë brenda kompetencave të saj dhe duke zhvilluar një procedurë të përcaktuar në mënyrë rigoroz nga ligji dhe Kushtetuta (*Vendimet nr.31, datë 1.12.2005 dhe nr.7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*).

Sa më sipër, rekursi, si mjet për rishikimin e vendimeve, ushtrohet vetëm për gabime të ndryshme të shkeljes së ligjit. Gjatë gjykimit, kolegji rishikon gjykimin e bërë mbi çështjet e së drejtës, por ai nuk mund të interpretojë faktet e çështjes, sepse është i detyruar t'i konsiderojë ato të mirëqena, ashtu siç janë vërtetuar, përshkruar e pranuar në vendimin e kundërshtuar.

Nga ky këndvështrim, nxjerrja e konkluzionit për provat në të kundërt me vlerësimin e dy gjykatave të shkallëve më të ulëta nuk pajtohet me natyrën e gjykimit në Gjykatën e Lartë. Sipas nenit 472 të K.Pr.Civile, ky kolegji ka në kompetencë t'i shqyrtojë problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural, por pa bërë një rivlerësim të provave në të kundërt me atë që kanë bërë gjykatat e hallkave më të ulëta (*Vendimi nr.17, datë 30.4.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjatë shqyrtimit të çështjeve Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë së vendimeve të ankmuara. Një kontroll i tillë konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykatat e faktit dhe të apelit, por pa i ndryshuar ato (*Vendimi nr.7, datë 9.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese*).

Duke analizuar rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr.781, datë 12.6.2007, duke pranuar **“mosekzistencën e marrëdhënies së detyrimit që rrjedh nga kontrata”** ka bërë vlerësim të kundërt për provat dhe faktet, jashtë vlerësimit nga dy shkallët e para të gjykimit të çështjes, që kanë pranuar se ... *fakti i ekzistencës së kontratës mes palëve vërtetohet me dokumentet e administruara në seancë gjyqësore, ku pala e paditur pranon se ka lidhur kontratë me palën paditëse Violeta Kanani. Gjithashtu, pagimi i një pjese të detyrimit në vlerën 9.500.000 lekë nga pala e paditur, duke pranuar dhe pjesën e papaguar, hedh poshtë dyshimin e mosekzistencës së një kontrate...”*.

Krejt ndryshe nga provat e faktet që pranojnë gjykatat, e shkallës së parë dhe e apelit, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, mbi të njëjtat prova, ka konkluduar se pretendimi i kërkueses për ekzistencën e një marrëdhënie detyrimi nuk është provuar gjatë seancës gjyqësore. Në këtë mënyrë kolegji ka vepruar në kundërshtim me nenin 485 të K.Pr.Civile, sipas të cilit ai ka të drejtë të vendosë prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë, si dhe të ndryshojë njëkohësisht vendimet e dy gjykatave më të ulëta, por nuk ka të drejtë, që mbi bazën e rivlerësimit të provave të administruara, të prishë të dy vendimet dhe të rrezojë kërkesën, e as t'i ndryshojë ato duke vendosur rrezimin e padisë (*Vendimi nr.31, datë 01.12.2005 i Gjykatës Kushtetuese*).

Rëndësi për çështjen ka dhe fakti se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, më përpara, me vendimin nr.572, datë 14.2.2004 ka vendosur prishjen e vendimit nr.514, datë 26.12.2003 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe ka vendosur dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë me tjetër trup gjykues, duke i pranuar provat e faktet, ashtu siç i kanë pranuar dhe vlerësuar gjykatat më të ulëta dhe duke urdhëruar hetimin për përcaktimin e saktë të shumës së detyrimit të Bashkisë ndaj kërkueses. Pas kësaj, gjykata e apelit ka marrë ekspert dhe ka vlerësuar shumë e detyrimit sipas orientimit të dhënë nga Kolegji, duke u mbështetur e duke i vlerësuar provat ashtu siç ishin vlerësuar më parë dhe, me vendimin nr.8, datë 7.3.2006 ka vendosur përsëri lënien në fuqi të vendimit nr.909, datë 29.5.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

Nga sa më lart, Gjykata konstaton se nëpërmjet paragrafit të fundit të vendimit, sipas të cilit: *“Paditësja nuk arriti të provojë se ndërmjet saj dhe anës së paditur ka një marrëdhënie detyrimi e lindur kjo nga kontrata ose nga ligji dhe për pasojë, ajo nuk mund të kërkojë gjyqësisht ekzekutimin e një detyrimi, i cili nuk provohet ...”*, Kolegji ka gabuar, pasi ka interpretuar ligjin duke rivlerësuar provat dhe duke deformuar rrethanat e çështjes.

Nga sa u parashtrua Gjykata vlerëson, se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, duke vendosur rrezimin e padisë me argumentin se paditësja nuk ka pranuar ekzistencën e një kontrate ndërmjet saj dhe anës së paditur, ka vlerësuar provat, madje në të kundërtën e vlerësimit që u ka bërë këtyre provave gjykatat e shkallës së parë dhe e apelit, dhe e ka zgjidhur vetë çështjen, krejt ndryshe nga ato, duke dalë kështu jashtë funksionit kushtetutes të rishikimit dhe për rrjedhojë, ka shkelur të drejtën e kërkueses për një proces të rregullt ligjor.

Lidhur me pretendimin se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk e ka arsyetuar vendimin.

Sipas kërkueses, me vendimin e dytë nr.781, datë 12.6.2007 Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë nuk u ka dhënë përgjigje të arsyetuara dhe logjike provave të pranuar nga dy gjykatat më të ulëta, si dhe problemeve ligjore, duke shkelur edhe detyrimin për arsyetimin e vendimeve nga ana e gjykatave si pjesë e procesit të rregullt ligjor.

Në jurisprudencën e saj, Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsyetimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. K.Pr.Civile parashikon se gjykata e mbështet vendimin e saj vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor. Vendimet duhet të përmbajnë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Qëndrimet e vlerësimet e gjykatës mund të kontrollohen nga një gjykatë më e lartë sipas procedurave përkatëse dhe që kjo të jetë e mundur, duhet bërë arsyetimi i vendimit, nëpërmjet të cilit gjyqtari tregon me qartësi faktet dhe ligjin e zbatueshëm që e kanë çuar në një zgjedhje ndërmjet disa mundësive. Pra, gjyqtari duhet të shpjegojë arsyet e vendimeve të tij, duke iu referuar fakteve për të cilat është zhvilluar procesi, ligjeve të zbatueshme dhe kërkesave të ndryshme të palëve”. Po kështu, Gjykata ka theksuar se: *“Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i*

rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai është konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat procedurale dhe të formojnë një përmbajtje qartësisht koherente brenda vendimit, e cila përjashton çdo kundërtënie apo kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë gjithashtu të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese. Konkluzionet e pjesës arsyetuese duhet të bazohen jo vetëm në aktet ligjore, por edhe në parimet dhe rregullat që karakterizojnë mendimin e shëndoshë e logjik” (Vendimi nr.7, datë 9.3.2009 i Gjykatës Kushtetuese).

Në rastin në shqyrtim, Gjykata konstaton se argumentet e kërkuarit për një arsyetim jo logjik të vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nuk qëndrojnë, sepse kolegji nuk ka vepruar në kundërshtim me kërkesat e Kushtetutës dhe të Kodit të Procedurës Civile.

Lidhur me pretendimin e kërkuarës së Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë ka shkelur parimin e paanësisë.

Sipas kërkuarës është shkelur parimi i paanësisë, sepse Gjykata e Lartë ka vendosur dy herë për çështjen në kolegje të ndryshme, ku ka qënë i njëjti anëtar si relatori i çështjes dhe se kolegjet kanë mbajtur qëndrime të ndryshme për të njëjtën çështje. Në vendimin e dytë nr.781, datë 12.6.2007, ku është ndryshuar vendimi i gjykatës së faktit dhe apelit duke u rrëzuar padia, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka mbajtur qëndrim të ndryshëm nga qëndrimi i mëparshëm, me të cilin e ka pas kthyer çështjen për rishqyrtim vetëm për saktësimin e vlerës së detyrimit.

Parimi i paanësisë, i cili duhet të gjejë zbatim përkatësisht te çdo shqyrtim i çështjeve gjyqësore kërkon që secili nga vendimmarrësit, të mos ushqejë paragjykime në lidhje me çështjen e shtruar përpara tij dhe të mos veprojnë në mënyrë të tillë që të ndihmojnë interesat e vetëm njëres palë.

Për të vërtetuar shkeljen e parimit të paanshmërisë në një proces gjykimi duhet dalluar qëndrimi subjektiv, në të cilin bëhen përpjekje për t’u siguruar lidhur me bindjen personale të një gjyqtari në çështjen konkrete dhe qëndrimi objektiv, i cili përqendrohet në vlerësimin e garancive të mjaftueshme që mënjanojnë çfarëdolloj dyshimesh që janë të justifikueshme në këtë sferë (Vendimi nr.37, datë 22.12.2003 i Gjykatës Kushtetuese).

Veç sa më lart, paanësia e gjykatës në një proces pranohet se është një garanci kushtetuese për çdo individ dhe pranohet gjithashtu, se gjykimi, konsiderohet i paanshëm derisa njëra nga palët, në rrjedhën e procesit, të paraqesë prova për të vërtetuar të kundërtën (Vendimi nr.7, datë 11.3.2008 i Gjykatës Kushtetuese).

Ky koncept kushtetues ka të bëjë me faktin se kontrolli i ushtruar nga Gjykata Kushtetuese, përfshirë edhe rastet e shkeljes së të drejtave të individit nga një proces i parregullt ligjor, është një kontroll subsidiar që do të thotë, se individit duhet t’i ketë shterur mjetet dhe rrugët e tjera ligjore përpara se t’i drejtohet Gjykatës Kushtetuese. Juridiksioni kushtetues për shkelje të të drejtave themelore për një proces të rregullt, bëhet i mundur kur kërkuarësi të ketë shterur mjetet e ankimit pranë gjykatave të sistemit gjyqësor. Shterimi nënkupton që kërkuarësi duhet t’i shfrytëzojë, në shkallët e sistemit gjyqësor, të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara. Mjetet ligjore shterojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi” (Vendimi nr.15, datë 18.4.2007 i Gjykatës Kushtetuese).

Duke qënë kështu, Gjykata çmon se kërkuarësja nuk legjitimohet në lidhje me këtë pretendim, sepse nuk ka ezauruar në mënyrë efektive të gjitha mjetet procedurale për të vënë në vend të drejtën e saj për një proces të rregullt ligjor.

Si përfundim, Gjykata vlerëson se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor të kërkuarës vetëm në lidhje me pretendimin e parë, me funksionin e Gjykatës së Lartë në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr.781, datë 12.6.2007 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

- Dërgimin e çështjes për shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Kujtim Puto, Xhezair Zaganjori, Fehmi Abdiu, Sokol Sadushi, Admir Thanza.

Anëtarë kundër: Vladimir Kristo (kryetar), Sokol Berberi, Vitore Tusha, Petrit Pllloçi.

MENDIMI I PAKICËS

Jemi kundër vendimit të shumicës për këto arsye:

1. Shumica e vlerëson në mënyrë të njëanshme vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë (më poshtë Kolegji), kur i referohet vetëm një paragrafi të tij në të cilin thuhet se pretendimi i paditëses për ekzistencën e një marrëdhënie detyrimi nuk është provuar gjatë seancës gjyqësore. Shumica pretendon se Kolegji ka vepruar në kundërshtim me nenin 141 të Kushtetutës që parashikon juridiksionin rishikues të kësaj gjykate, sepse në kundërshtim edhe me kompetencat e përcaktuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, ka bërë vlerësim të ndryshëm të provave dhe fakteve të administruara nga gjykata e faktit dhe ajo e apelit.

2. Në kundërshtim me sa argumenton shumica, Kolegji ka vepruar në përputhje me nenin 141 të Kushtetutës dhe nenin 472, germa “a” të Kodit të Procedurës Civile duke qenë plotësisht brenda kornizave të juridiksionit të vet. Kolegji, kur shprehet në vendim se marrëdhënia juridike e detyrimit nuk është provuar, këtë vlerësim nuk e lidh me aspektin procedural të të provuarit, por e bën në funksion të interpretimit juridik të kuptimit të një marrëdhënieje detyrimi.

3. Kolegji i kushton në vendim një kre të veçantë (kreu III) interpretimit juridik të marrëdhënieve të detyrimit në funksion të çështjes konkrete, duke vepruar në këtë mënyrë si gjykatë ligji. Kolegji, referuar në provat e administruara në gjykimet e mëparshme, në kushtet e mungesës së një kontrate të shkruar midis palëve ndërgjyqëse, ka bërë interpretimin e ligjit kur arrin në përfundimin se mjafton që njëra prej palëve të kontestojë detyrimin që marrëdhënia konkrete të vihet në dyshim. Kolegji arsyeton, ndër të tjera, se “...pranimi i një detyrimi kërkon gjithnjë shprehjen e vullnetit të njëjës palë dhe kjo shprehje vullneti duhet të bazohet në një kontrate...”. Kërkesja Violeta Kanani asnjëherë gjatë gjykimeve të zhvilluara “... nuk ka pranuar ekzistencën e një kontrate midis saj dhe anës së paditur”. Kolegji konkludon se në kushtet e mungesës së një kontrate të shkruar, nuk mund të pretendohet se jemi përpara një marrëdhënieje detyrimi në kuptimin juridik.

4. Kolegji, duke vazhduar me interpretimin e ligjit, ka arritur në përfundimin se ligji është kuptuar dhe zbatuar keq nga gjykatat më të ulëta. Kolegji arsyeton më tej në vendim se gjykatat i janë referuar në mënyrë të përsëritur nenit 80 të Kodit Civil. “Ky nen, vazhdon arsyetimin kolegj, ka të bëjë me parimin e përgjithshëm të vlefshmërisë së një veprimi juridik dhe konkretisht një veprim juridik prezumohet se është i vlefshëm vetëm nëse vullneti i shfaqur për kryerjen e tij është i padyshimtë”. Duke arsyetuar dallimet juridike midis marrëveshjes për lidhjen e një kontrate si të tillë dhe formës me të cilën duhet të vishet një marrëdhënie juridike detyrimi që ajo të jetë e padyshimtë, Kolegji konkludon se palët duhet të lidhnin një kontratë të shkruar për të shmangur mosmarrëveshjet meqenëse “...në asnjë rast pala e paditur nuk ka pranuar detyrimin e saj”. Këto

janë arsyet për të cilat Kolegji ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier dhe rrëzimin e kërkesëpadisë së Violeta Kananit.

5. Duke vepruar si më sipër, ndryshe nga sa pretendohet në vendimin e shumicës, Kolegji ka respektuar edhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese. Kështu, në vendimin nr.7, datë 9.3.2009 të kësaj Gjykate thuhet ndër të tjera se Gjykata e Lartë nuk merr prova, por shqyrton dhe analizon çështjen në drejtim të kontrollit të ligjshmërisë dhe bazueshmërisë të vendimeve të ankimuara, kontroll i cili konsiston në analizën e plotë të fakteve dhe rrethanave, të cilat janë pranuar më parë si të vërteta nga gjykata e faktit dhe apelit. Nuk rezulton asnjë fakt apo rrethanë që Kolegji të ketë marrë prova apo të ketë bërë vlerësim të ndryshëm të tyre. Përkundrazi, Kolegji ka bërë atë që ka theksuar në mënyrë të përsëritur Gjykata Kushtetuese në jurisprudencën e saj; ka shqyrtuar problemet që kanë të bëjnë me mosrespektimin ose zbatimin e gabuar të ligjit material e procedural (*Vendimi nr.17, datë 30.4.2007 i Gjykatës Kushtetuese*).

Së fundi, nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese të vlerësojë nëse interpretimi i ligjit i bërë nga kolegjet e Gjykatës së Lartë është ose jo i drejtë, sepse nuk është pjesë e juridiksionit të saj kushtetues. Një qëndrim i kundërt do ta kthente Gjykatën Kushtetuese në një gjykatë të shkallës së katërt të juridiksionit të zakonshëm.

Anëtar
Petrit Ploçi

Kryetar
Vladimir Kristo

VENDIM
Nr.93, datë 15.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
KESH SHA PËR PERIU DHËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b; 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.71, datë 12.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për vitin 2010”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës për prodhimin e energjisë elektrike për vitin 2010, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e prodhimit të energjisë elektrike nga KESH sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 0.40 lekë/kwh.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.94, datë 15.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGIJË ELEKTRIKE TË
PRODHUAR NGA TEC VLORË SHA TE FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË PËR
PERIUdhËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.57, datë 3.8.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit të TEC Vlora sh.a. për tarifën e shitjes së energjisë elektrike tek FPSH”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e TEC Vlora sh.a., si dhe relacionin e grupit të punës,

VENDOSI:

1. Çmimi i shitjes së energjisë elektrike të prodhuar nga TEC Vlora sh.a. te furnizuesi publik me shumicë, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 1,432 lekë/MW/muaj kosto fikse dhe 13.0 lekë/kwh për energji.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e TEC Vlorë sh.a. dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.95, datë 15.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË ENERGIJË ELEKTRIKE PËR FURNIZUESIN
PUBLIK ME SHUMICË PËR PERIUdhËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b; 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, vendimit nr.72, datë 12.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2010”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e KESH sh.a. për përcaktimin e tarifës së energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për vitin 2010, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1.Tarifa e energjisë elektrike për furnizuesin publik me shumicë për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 2.03 lekë/kwh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.96, datë 15.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA OST SHA PËR PERIU DHËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b; 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.73, datë 12.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike nga OST sh.a. për vitin 2010”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OST sh.a. për përcaktimin e tarifës së transmetimit të energjisë elektrike për vitin 2010, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e transmetimit të energjisë elektrike për OST sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 0.60 lekë/kwh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OST sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.97, datë 15.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE PËR TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HIDROCENTRALET EKZISTUESE ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 10 MW PËR PERIU DHËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010

Në mbështetje të neneve 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.5, datë 26.1.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për 8342

përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri 10 MW për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 7,40 lekë/kwh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe të KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.98, datë 15.12.2009

PËR PËRCAKTIMIN E TARIFËS SË SHPËRNDARJES SË ENERJISË ELEKTRIKE NGA OSSH SHA PËR PERIUDHËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b; 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes të energjisë elektrike”, vendimit nr.74, datë 12.10.2009 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për fillimin e procedurave për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për vitin 2010”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike për vitin 2010, si dhe relacionin e grupit të punës të ERE-s,

VENDOSI:

1. Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 5.70 lekë/kwh për klientët tariforë.

2. Tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike për OSSH sh.a. për klientët e kualifikuar dhe furnizuesit e kualifikuar të jetë sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.20, datë 14.2.2008.

3. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e OSSH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.100, datë 15.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË ENERGJISË
ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORË PËR PERIUdhËN 1 JANAR-31
DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 8, pika 2, germa b; 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.77, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për kompaninë publike të gjenerimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë të energjisë elektrike”, vendimit nr 5, datë 26.1.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet ekzistuese me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, vendimit nr.24, datë 11.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, vendimit nr.59, datë 29.12.2005 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së transmetimit të energjisë elektrike”, vendimit nr.79, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike”, vendimit nr.80, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi aplikimin e OSSH sh.a. për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë,

VENDOSI:

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar 2010 -31 dhjetor 2010, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

Tarifat e shërbimeve dhe të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për vitin 2010

Niveli i tensionit	Kategoritë e konsumatorit	Viti 2010		
		Çmimi (Lekë/kwh)	Çmimi i energjisë në pik (lekë/kwh)	Çmimi i energjisë reaktive (lekë/kvar)
Tensioni i lartë	Klientë të transmetimit TL me asete të zotëruar prej tyre			
	Industri	6.20	9.00	0.93
	Tregti & shërbime			
	Bujqësi			
	Të tjerë			
	Klientë të furnizuar në N/S 110 kV të shpërndarjes			
	Industri	8.00		1.20
	Tregti & shërbime	8.00	9.64	1.20
Tensioni i mesëm	Bujqësi	8.00		1.20
	Të tjerë	8.00		1.20
	Klientë të furnizuar në 35 kV			
	Industri	8.50		1.28
	Tregti & shërbime	8.50	10.00	1.28
	Bujqësi	8.50		1.28
	Të tjerë	8.50		1.28
	Klientë të furnizuar në 20/10/6 kv			
	Industri	9.10	12.50	1.37
	Tregti & shërbime	10.00	12.50	1.50
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	12.50	1.07
	Bujqësi	8.70	12.50	1.31
Të tjerë	9.70	12.50	1.46	
Tensioni i ulët	Buxhetorë	11.50	12.50	1.73
	Klientë të furnizuar në TU			
	Industri	10.50		
	Tregti & shërbime	12.20		
	Furra buke, prodhim mielli	7.60		
	Bujqësi	10.50		
	Të tjerë	12.00		
	Buxhetorë	14.00		
	Familjarë			
	Blloku i parë deri në 300 kwh	7.70		
	Blloku i dytë mbi 300 kwh	13.50		
	Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (lekë/muaj)	200		
	Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompë, ashensor, etj. (lekë/kWh)	8.00		
Mesatare totale	9.53			

Orari pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është:

Për periudhën 1 nëntor-31 mars nga ora 18:00 deri 22:00

Për periudhën 1 prill-31 tetor nga ora 19:00 deri 23:00

VENDIM
Nr.101, datë 15.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT UNIK TË SHITJES SË ENERGISË ELEKTRIKE PËR
TË LICENCUARIT PËR PRODHIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE NGA
HIDROCENTRALET E RINJ ME FUQI TË INSTALUAR DERI NË 15 MW PËR
PERIUDHËN 1 JANAR-31 DHJETOR 2010**

Në mbështetje të neneve 9; 26 pika 1; 27 dhe 28 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr.87, datë 16.1.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.27, datë 19.1.2007 “Për miratimin e rregullave të vlerësimit dhe të dhënies së koncesioneve”, neneve 15; 20 dhe 21 të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.21, datë 18.3.2009, vendimit nr.24, datë 11.4.2007 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të çmimit unik të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 10 MW”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 15.12.2009, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve për përcaktimin e çmimeve të shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010,

VENDOSI:

1. Çmimi unik i shitjes së energjisë elektrike për të licencuarit për prodhimin e energjisë elektrike nga hidrocentralet e rinj me fuqi të instaluar deri në 15 MW, për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010 do të jetë 6.00 lekë/kwh.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e të licencuarve dhe KESH sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishita

VENDIM
Nr.102, datë 21.12.2009

**PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GSA” SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË
KUALIFIKUAR TË ENERGISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe nenit 45 pikat 3 dhe 4 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 21.12.2009, mbasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “GSA” sh.p.k. plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germa “a”, “b” dhe “c”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “GSA” sh.p.k. në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike.
2. Vlefshmëria e licencës të fillojë nga data e përfundimit të licencës aktuale.
3. Kjo licencë të hyjë në fuqi në datën 26.1.2010 dhe të ketë vlefshmëri deri më datën 25.1.2015.
4. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojnë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM

Nr.103, datë 21.12.2009

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET TERMOCENTRALIT VLORË SHA (TEC VLORA SHA) DHE SHOQËRISË KESH SHA (FURNIZUESI PUBLIK ME SHUMICË)

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, pikës 4.13 germa “a”, pika 5, të modelit të tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, pikës V.1 të rregullave të tregut të energjisë elektrike të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.68, datë 23.6.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2009, pasi diskutoi mbi draftin e “Marrëveshjes së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet termocentralit Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.) dhe shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë)”,

konstatoi se:

- Kontrata është lidhur nga KESH sh.a. dhe TEC Vlora sh.a., subjekte të licencuara nga ERE, përkatësisht me vendimet nr.11, datë 23.6.2006 dhe nr.11, datë 2.3.2009;
- Modeli i tregut shqiptar të energjisë elektrike dhe rregullat e tregut të energjisë elektrike, përcaktojnë që kjo marrëveshje i nënshtrohet tregut të rregulluar;
- Në referencë të sa më sipër, ERE është autoriteti i përcaktuar për miratimin e kësaj marrëveshjeje;

Për sa më sipër konstatuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

I. Miratimin e marrëveshjes së shitblerjes së energjisë elektrike ndërmjet termocentralit Vlorë sh.a. (TEC Vlora sh.a.) dhe shoqërisë KESH sh.a. (furnizuesi publik me shumicë), me ndryshimet si më poshtë:

1. Tek palët: “Korporata Elektroenergjetike Shqiptare KESH sh.a.”, të shtohet “në cilësinë e furnizuesit publik me shumicë.”

2. Neni 10 pika 4 të riformulohet:

“Pas përfundimit të kënaqshëm të komisionimit, Blerësi do të kryejë testet e provave të funksionimit të centralit që mund të ndiqen lirisht nga Shitësi. Pas përfundimit të kënaqshëm të testeve të provës së funksionimit të centralit, inxhinieri i pavarur do të lëshojë një certifikatë adresuar Blerësit dhe Shitësit, që vërteton pa asnjë kualifikim që kontraktuesi EPC ka instaluar të gjitha pajisjet e centralit të specifikuara në specifikimet funksionale, që komisionimi i centralit është kryer, që centrali është i disponueshëm për operim të plotë komercial dhe që certifikon se kapaciteti i kontraktuar, norma e konsumit specifik të lëndës djegëse e kontraktuar, si dhe normat e performancës mjedisore (ku përfshihen norma e hedhjes së gazrave të dëmshme në atmosferë dhe norma e zhurmave në fushë të hapur), janë arritur nga centrali gjatë testeve të provave të funksionimit të centralit”.

3. Neni 15, pika 1, fjalia e parë të riformulohet:

“Jo më pak se një herë për çdo rast riparimi kapital të planifikuar për turbinën me gaz, pas përafërsisht 25 000 orë pune ekuivalente, pas përfundimit të mirëmbajtjes së planifikuar, Shitësi do të realizojë një test të kapacitetit të kontraktuar, një test të konsumit specifik të lëndës djegëse të kontraktuar dhe një test të normave të performancës mjedisore të kontraktuar.”

4. Neni 19 pika 2 të riformulohet:

“Pas ditës së fillimit Shitësi do të shesë dhe Blerësi do të blejë, në përputhje me këtë nen dhe nenin 20 të kësaj marrëveshjeje, të gjithë prodhimin e kontraktuar të energjisë elektrike të livruar në përputhje me instruksionet e dispeçerimit”.

5. Neni 19 pika 3 të riformulohet:

“Pagesat e energjisë. Blerësi do t’i paguajë Shitësit pagesat e energjisë sipas tarifës së përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, lidhur me prodhimin neto të energjisë elektrike të livruar në përputhje me instruksionet e dispeçerimit”.

6. Neni 19 pika 6 fjalia e parë të riformulohet:

“Pagesa e kapacitetit. Blerësi, në varësi të muajit në të cilin bie data e fillimit dhe për çdo muaj më pas, gjatë periudhës së marrëveshjes, do ta paguajë Shitësin për kapacitetin e kontraktuar sipas tarifës për kapacitet të përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë.”

7. Neni 19, pika 7 të hiqet.

8. Neni 20.2, fjalia e parë të riformulohet:

“Çdo faturë e përgatitur nga Shitësi duhet të jetë në përputhje me nenin 19.3 dhe nenin 19.6 të kësaj marrëveshjeje dhe duhet të përmbajë informacionin e përcaktuar në aneksin 10.”

II. KESH sh.a., në cilësinë e furnizuesit publik me shumicë, ka të drejtë të blejë energjinë elektrike të prodhuar nga TEC Vlora sh.a., në përputhje me parimin e planifikimit me koston më të ulët.

III. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojnë KESH sh.a. dhe TEC Vlora sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.104, datë 22.12.2009

**PËR PËRCAKTIMIN E KOHËZGJATJES PËR FATURIMIN AFORFE PËR KLIENTËT
FAMILJARË PA MATËS TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 52 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 22.12.2009, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë OSSH sh.a. për shtyrjen e afatit të instalimit të matësve për klientët e OSSH sh.a.,

VENDOSI:

1. Afati i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë të energjisë elektrike që nuk janë të pajisur me matës të jetë, deri në 30.4.2010.
2. Sasia e energjisë elektrike e faturimit aforfe për klientët familjarë pa matës të energjisë elektrike (ndarë sipas rretheve), do të jetë e njëjtë me përcaktimet e tabelës sipas vendimit nr.12, datë 28.1.2008.
3. Ky afat i aplikimit të faturimit aforfe për klientët familjarë që nuk janë të pajisur me matës të energjisë elektrike, shtohet në licencën e aktivitetit të shpërndarjes, të dhënë OSSH sh.a. sipas vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.114, datë 1.10.2008.
4. Ngarkohet OSSH sh.a për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.105, datë 28.12.2009

**MBI ANKIMIN E OSSH SHA PËR VENDIMET E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR.98,
DATË 15.12.2009 DHE NR.100, DATË 15.12.2009**

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 16 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 28.12.2009, mbasi analizoi kërkesën e OSSH sh.a. për ankimin e vendimeve të ERE-s nr.98 dhe nr.100, datë 15.12.2009, të dërguara nga OSSH sh.a. me datë 18.12.2009, dhe relacionin e grupit të punës së ERE-s për këtë çështje,

konstatoi se:

- Argumentet e OSSH sh.a., të dërguara në kërkesën e saj të datës 18.12.2009, janë riformulime të argumenteve dhe shpjegimeve të paraqitura gjatë seancave teknike të zhvilluara nga ERE, të cilat janë marrë në analizë gjatë procesit të përcaktimit të tarifave dhe çmimeve nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, me shumicën e votave të anëtarëve të tij,

VENDOSI:

1. Të mos marrë parasysh në cilësinë e provave të reja argumentet e paraqitura në ankesën e OSSH sh.a. të datës 18.12.2009, në lidhje me vendimet e Bordit të Komisionerëve nr.98, datë 15.12.2009 dhe nr.100, datë 15.12.2009.

2. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.98, datë 15.12.2009 “Për përcaktimin tarifës së shpërndarjes së energjisë elektrike nga OSSH sh.a. për periudhën 1 janar-31 dhjetor 2010”.

3. Lënien në fuqi të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.100, datë 15.12.2009 “Për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën 1 janar 2010-31 dhjetor 2010.

4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë OSSH sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.106, datë 29.12.2009

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ENERGJI ASHTA” SHPK

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1 germa “a”, dhe neneve 13 e 14 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuara me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “Energji Ashta” sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson plotësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Energji Ashta” sh.p.k. në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike.

2. “Energji Ashta” sh.p.k. të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga HEC Ashta sipas afatit të përcaktuar në marrëveshjen e koncesionit.

3. Afati i vlefshmërisë së licencës të jetë 30 vjet.

4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.107, datë 29.12.2009

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “HEC BISHNICA 1, 2” SHPK

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa “a”, nenit 9 dhe 13 pika 1, germa “a” të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “a”, dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.108, datë 9.9.2008, nenit 18, pika 1, germa “a” të rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr.21, datë 18.3.2009, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2009, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “HEC Bishnica 1,2”sh.p.k., për t’u licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, për HEC Bishnica 2, dhe konstatoi se:

Aplikimi plotëson përgjithësisht kërkesat e ERE-s, lidhur me licencimet në sektorin e energjisë elektrike të:

- Formatit të aplikimit (neni 9, pika 1);
- Dokumentacionit juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2);
- Dokumentacionit financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3);
- Dokumentacionit teknik (neni 9, pika 4).

Mungesa e dokumentacionit që ka të bëjë me:

Miratimin e OST sh.a. ose OSSH sh.a. për lidhjen e centraleve me sistemin elektroenergjetik është shoqëruar nga miratimi për pikën e lidhjes nga Drejtoria Rajonale e OST sh.a. Elbasan dhe është në pritje të përgjigjes nga Drejtoria Qendrore për ta paraqitur më pas në ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për licencimin e shoqërisë “HEC Bishnica 1,2” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike për HEC Bishnica 2.

2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut ta njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
Nr.108, datë 29.12.2009

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.29, DATË 16.4.2009 “PËR PËRCAKTIMIN E PAGESAVE TË RREGULLIMIT PËR VITIN 2009 PËR TË LICENCUARIT NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 121 dhe 126 të ligjit nr.8485, datë 12.5.2008 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 29.12.2009, mbasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.29, datë 16.4.2009 “Për përcaktimin e pagesave të rregullimit për vitin 2009 për të licencuarit në sektorin e energjisë elektrike” në tabelën për pagesat e rregullimit për vitin 2009 bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

- Në pikën 20 pagesa e rregullimit për TEC Vlora sh.a. bëhet 10 000 lekë.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ta njoftojë TEC Vlora sh.a. për këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Bujar Nepravishta

VENDIM
(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin nr.1995, datë 9.12.2009, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Veri Dalip Dika, lindur në 23.3.1954, si dhe caktimin si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij, bashkëshorten e tij Trëndeline Dika.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 6.1.2010
Doli nga shtypi më 8.1.2010

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë